



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:093779

Datë: 16.10.2024

Numri i dokumentit: 06302272

PKR.nr.481/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi me bashkëpunëtoren profesionale **Arbenita Hoxha Koleci**, në çështjen penale të akuzuarit D.S., i akuzuar për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë, nga neni 178, lidhur me nenin 28 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.3/15, të datës 25.08.2016, pas njoftimit të prokurorit të shtetit PP.I.nr 114/20 të datës 02.02.2024, duke u bazuar në dispozitën e nenit 287, par. 1 dhe 2 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale - KPP, jashtë seancës, më datë 16.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- **HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.3/15, të datës 25.08.2016 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të akuzuarit

D.S., i biri i F. dhe Z., e vajzërisë K., i lindur me datë ..., në T., me banim në Prishtinë, rruga "...", pa numër, me numër personal ..., shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës,

- për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë, nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPRK,

- **sepse prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale, për veprën penale si më lart.**

- Shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

- **Të dëmtuarit G.(N.)S.** nga F., rruga "...", ..., numër ... (...), **dhe N.(U.)H.** nga Prishtina, lagjja "...", ..., pa numër (...), për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës, Njësia e Hetimeve Rajonale në Prishtinë nr.2015-AB-0024, të datës 03.01.2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.3/15, të datës 25.08.2016, e ka akuzuar të pandehurin D.S., për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë, nga neni 178, lidhur me nenin 28 të KPRK.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 13.11.2017, por në seancë ka munguar i akuzuari D.S., për të cilin prindi i tij e ka njoftuar gjykatën se i njëjti gjendet në Suedi, ku jeton dhe punon, dhe se në Kosovë do të vijë kur ta ketë pushimin.

Pas shikimit dhe vlerësimit të aktakuzës dhe shkresave tjera të lëndës, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se aktakuza është e mangët dhe nuk është hartuar konform nenit 235 të KPP, dhe e njëjta duhet të kthehet për plotësim për tu përpiluar konform dispozitave të këtij kodi. Andaj, në bazë të neneve 235 par. 4 dhe par.1 nënpar. 1.5, dhe 441 të KPP, me datë 30.09.2024 gjykata ka kthyer në plotësim aktakuzën PP/I-nr. 3/15, të datës 25.08.2016, për të akuzuarin D.S., për shkak se, sa i përket të akuzuarit D.S. nuk janë përcaktuar veprimet e ndërmarra në cilësi të të akuzuarit, si veprime inkriminuese janë përshkruar ato të tani të dëmtuarit G.S., të përshkruara si në vijim “tani i dëmtuari G.S. e godet me grushte në fytyrë dhe në hundë dhe e merr çelësin për veturë dhe e godet disa herë në kokë me çka i shkakton lëndime të rënda trupore dhe e len të alivanosur përtokë”, ndërsa si veprime të të akuzuarit paraqiten: ”i pandehuri D.S. nuk i ka lejuar që të hyjnë në lokal për një moment fillojnë të përleshën në atë mënyrë që i pandehuri” e këtu ndërpritet përshkrimi i veprimeve të tani të akuzuarit D.S..

Sipas gjykatës, aktakuza nuk ka përmbajtur të dhënat e parapara me nenin 235, par. 1.5 të KPP, përkatësisht në dispozitiv të aktakuzës nuk janë përshkruar veprimet e të pandehurit D.S., i cili sipas prokurorisë akuzohet për kryerjen e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK, e për këtë, në bazë të nenit 441 të KPP, gjykata ka kthyer në plotësim aktakuzën si më lart, me qëllim që t’i mënjanoj mangësitë e përshkruara si më lart dhe ta plotësoj të njëjtën në afat prej 14 ditësh, përkatësisht deri me datë 14.10.2024, me paralajmërimin se nëse nuk bëhet plotësimi i saj brenda këtij afati, konsiderohet se është hequr dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit D.S. dhe gjykata do ta hedhë akuzën.

Me shkresën të datës 15.10.2024, prokurori i shtetit e ka njoftuar gjykatën se pas shikimit të shkresave të lëndës, prokuroria ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit D.S. nuk ka elemente të veprës penale të Vrasjes në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK, duke shtuar se ekziston mundësia që të ketë elemente të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 të KPRK, por bazuar në nenin 106, par. 1.6 të KPRK tani ka një parashkrim absolut të ndjekjes penale, dhe bazuar në të lart përmendurat dhe në nenin 51 të KPP, prokuroria është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit D.S. për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 178 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK.

Pasi që, prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit D.S., i akuzuar për shkak të veprës penale si në dispozitiv të këtij aktvendimi, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 453, par. 1 të KPP.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, në bazë të nenit 462, par. 1 dhe 3 të KPP, të dëmtuarit janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 287, par. 1 dhe 2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky aktvendim është përpiluar me datë 16.10.2024.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.481/2016, datë 16.10.2024

Bashkëpunëtore profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar, brenda tre (3) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktvendimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.